

**ROLI I INSTITUCIONEVE KORREKTUESE NË
RISOCIALIZIMIN E GRAVE TË BURGOSURA: RASTI I
BURGUT TË LIPJANIT**

TEMA PËR TITULLIN
MASTER E SOCIOLOGJISË
NGA
ALBANA SHAHINI HETEMI



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË**

**PRISHTINË
QERSHOR, 2026**

Rezyme

Mentori:

Dr. Prof. Ardian Gola

Në punimin shkencor të Masterit kam hulumtuar temën “Roli i Institucioneve Korrektuese në risocializimin e grave të burgosura: Rasti i Burgut të Lipjanit”. Studimi ka për qëllim të analizojë rolin e institucioneve korrektuese në procesin e risocializimit të grave të burgosura, duke u fokusuar në përvojat e tyre brenda institucionit, efektivitetin e programeve rehabilituese dhe sfidat që lidhen me riintegrimin e tyre në shoqëri pas përfundimit të dënimit.

Institucionet korrektuese nuk kanë vetëm funksion ndëshkues, por edhe rol të rëndësishëm në rehabilitimin dhe përgatitjen e individëve për rikthim në jetën shoqërore. Në këtë kontekst, studimi është përqendruar në Burgun e Lipjanit si institucioni i vetëm korrektues në Kosovë për gratë e burgosura, duke analizuar mënyrën se si programet rehabilituese dhe marrëdhëniet institucionale ndikojnë në procesin e risocializimit.

Në punim janë përdorur metoda cilësore të hulumtimit. Të dhënat empirike janë mbledhur përmes intervistave gjysmë të strukturuar me gjashtë gra të burgosura dhe dhjetë anëtarë të stafit korrektues, duke përfshirë zyrtarë korrektues, punonjës socialë, edukatorë, psikologë dhe personel administrativ. Gjithashtu është përdorur metoda e vëzhgimit jo-pjesëmarrës në ambientet ku zhvillohen aktivitetet edukative dhe profesionale brenda institucionit.

Në kapitullin e parë është trajtuar korniza teorike dhe konceptuale e studimit. Janë analizuar konceptet e socializimit dhe risocializimit, teoritë sociologjike mbi institucionet korrektuese, si dhe qasjet bashkëkohore lidhur me rehabilitimin e personave të privuar nga liria. Në këtë kapitull është diskutuar veçanërisht koncepti i “institucionit total” i Erving Goffman-it, sipas të cilit institucionet korrektuese ndikojnë në identitetin dhe autonominë e individëve, si dhe teoria e risocializimit e Berger dhe Luckmann, e cila shpjegon procesin e riinternalizimit të normave dhe roleve shoqërore.

Në kapitullin e dytë është trajtuar sistemi korrektues dhe pozita e grave të burgosura në kontekstin institucional dhe shoqëror. Janë analizuar karakteristikat e institucioneve korrektuese,

sfidat me të cilat përballen gratë në sistemin penal dhe rëndësia e programeve rehabilituese në përgatitjen e tyre për jetën pas burgimit. Po ashtu është diskutuar literatura bashkëkohore sociologjike dhe kriminologjike që trajton dimensionin gjinor të kriminalitetit dhe rehabilitimit.

Në kapitullin e tretë është paraqitur metodologjia e hulumtimit. Studimi është realizuar përmes kampionimit të qëllimshëm, duke përfshirë gra të burgosura me moshë, përvojë dhe kohëzgjatje të ndryshme të dënimit, si dhe staf korrektues me përvoja të ndryshme profesionale. Analiza e të dhënave është realizuar përmes metodës së analizës tematike, e cila ka mundësuar identifikimin e temave kryesore që lidhen me përvojat e grave dhe perceptimet e stafit korrektues mbi procesin e risocializimit.

Në kapitullin e katërt janë paraqitur rezultatet empirike të studimit. Analiza e të dhënave tregon se shumica e grave të burgosura përjetojnë vështirësi emocionale dhe psikologjike në fazën fillestare të burgimit, të shoqëruara me ndjenjë izolimi dhe pasigurie. Megjithatë, me kalimin e kohës ato zhvillojnë mekanizma adaptues dhe arrijnë të përshtaten me jetën institucionale.

Rezultatet tregojnë se programet rehabilituese luajnë rol të rëndësishëm në procesin e risocializimit. Gratë e intervistuar kanë marrë pjesë në aktivitete dhe trajnime të ndryshme si rrobaqepësi, shkenca kompjuterike, kulinari, filigran, art mural, menaxhim biznesi, menaxhim të zemërimit dhe programe të tjera edukative e sociale. Shumica e tyre i kanë vlerësuar këto programe si shumë të dobishme për zhvillimin personal dhe profesional, duke theksuar se aftësitë e fituara mund të kontribuojnë në integrimin e tyre në tregun e punës pas lirim.

Një gjetje e rëndësishme lidhet me marrëdhëniet sociale brenda institucionit. Pjesa më e madhe e grave të intervistuar kanë deklaruar se trajtohen me respekt dhe dinjitet nga stafi korrektues. Mbështetja institucionale, komunikimi pozitiv dhe marrëdhëniet e mira ndërpersonale konsiderohen faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në motivimin për ndryshim dhe në suksesin e procesit rehabilitues.

Nga ana tjetër, studimi ka identifikuar edhe sfida që lidhen me kufizimin e autonomisë personale, ndikimin e kulturës institucionale dhe nevojën për programe më inovative dhe më të përshtatura me nevojat specifike të grave të burgosura. Disa pjesëmarrëse kanë theksuar rëndësinë e

mbështetjes psikologjike dhe të programeve që adresojnë traumat, përvojat e dhunës dhe sfidat sociale me të cilat përballen gratë para dhe pas burgimit.

Studimi ka treguar se procesi i risocializimit nuk kufizohet vetëm në pjesëmarrjen në programe rehabilituese, por përfshin një transformim më të gjerë social dhe psikologjik. Risocializimi lidhet me rindërtimin e identitetit personal, rikthimin e vetëbesimit, zhvillimin e aftësive sociale dhe profesionale, si dhe me përgatitjen për një jetë të pavarur dhe produktive pas lirimit.

Një dimension i rëndësishëm i studimit është aspekti gjinor i risocializimit. Rezultatet tregojnë se shumë gra të burgosura kanë përjetuar forma të ndryshme të marginalizimit social, varfërisë, dhunës ose përjashtimit shoqëror para burgimit. Për këtë arsye, programet rehabilituese duhet të jenë të ndjeshme ndaj nevojave specifike të grave dhe të përfshijnë komponentë që adresojnë aspektet emocionale, sociale dhe ekonomike të jetës së tyre.

Në përfundim, studimi dëshmon se institucionet korrektuese mund të luajnë rol të rëndësishëm në procesin e risocializimit të grave të burgosura, nëse programet rehabilituese zbatohen në mënyrë të vazhdueshme dhe përshtaten me nevojat individuale të pjesëmarrëseve. Mbështetja profesionale, marrëdhëniet pozitive me stafin korrektues dhe zhvillimi i aftësive praktike paraqiten si faktorë kyç për një riintegrim të suksesshëm në shoqëri.

Bazuar në rezultatet e studimit rekomandohet zgjerimi i programeve rehabilituese, forcimi i dimensionit gjinor në trajtimin korrektues, rritja e bashkëpunimit ndërinstitutional për mbështetjen e grave pas lirimit, monitorimi i vazhdueshëm i programeve rehabilituese dhe investimi në trajnimin profesional të stafit korrektues. Këto masa mund të kontribuojnë në përmirësimin e procesit të risocializimit dhe në zvogëlimin e rrezikut të rikthimit në kriminalitet.

Ky studim paraqet një kontribut të rëndësishëm në literaturën sociologjike dhe kriminologjike në Kosovë, duke ofruar një analizë empirike të përvojave të grave të burgosura dhe të stafit korrektues në Burgun e Lipjanit. Gjetjet e studimit mund të shërbejnë si bazë për zhvillimin e politikave dhe praktikave më efektive në fushën e rehabilitimit dhe riintegrit social të grave të burgosura.